



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 193, Datë 29/12/2016

Mbështetur në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa numër 68, datë 13.07.2016, e bërë nga shtetasi kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të gjendjes shoqërore, si i dënuar me burgim.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Z. .... me shkresën: “Ankesë” datë 08.07.2016 i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe për dijeni i është drejtuar, Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Ministrit të Drejtësisë, Komitetit Shqiptar të Helsinkit si dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sipas shpjegimeve të dhëna, z. .... në mes të tjerash<sup>1</sup>, informon se, në burgun e Zaharisë ujërat e zeza depërtojnë tavanin ku kalon ushqimi, në dushe rrjedhin ujërat e zeza me muaj rresht, si dhe rrjetat e telave në dritare po i marrin frymën.

Gjendja shoqërore është një nga shkaqet për të cilat Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

<sup>1</sup> Në lidhje me pretendimet e tjera të z. .... për gjendjen shëndetësore, Komisioneri është shprehur me Vendimin nr.113, datë 22.06.2016.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.757 prot, datë 27.07.2016 të Komisionerit është njoftuar Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe Drejtori i Institutit të Ekzekutimit të Veprave Penale, Zaho, Krujë, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesës si dhe iu kërkua informacion mbi pretendimin e ngritur nga z

Duke mos patur përgjigje zyrtare nga dy Institucionet sipërcituar,

2. Me shkresën me nr.757/1 prot., datë 05.09.2016 të Komisionerit i është bërë rishtaz një kujtesë Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve<sup>2</sup>, lidhur dhënien e informacionit të kërkuar për trajtimin e çështjes së -

➤ Me shkresën me nr.5850/2 prot., datë 15.09.2016, DPB informon Komisionerin se: *“Lidhur me problematikën e infrastrukturës, Sektori i Shërbimeve dhe Projekteve të DPB-së është në dijeni dhe po merr masa për sigurimin e fondeve, ndërsa për eliminimin e lagështirës është ngarkuar I EVP Krujë për zgjidhjen e menjëhershme të këtij problemi. Po ashtu ky Sektor pas marrjes së kërkesës së Komisionerit, ka kontaktuar menjëherë me shefin e logjistikës së I EVP Krujë (konkretisht me datë 02.08.2016) për rregullimin e rrjedhjeve të tubacioneve dhe eliminimin e lagështirës. Gjithashtu, DPB është në dijeni të problematikave të hasura në këtë I EVP, si pasojë e amortizimit të këtij Institucioni dhe po punojmë në vazhdimësi për përmirësimin e tyre”.*

➤ Me shkresën me nr.542 prot., datë 11.11.2016, I EVP Krujë informon Komisionerin se<sup>3</sup>: *“...e vetmja mangësi është godina e vjetër dhe e amortizuar e cila ka lagështi në disa dhoma, mungesë të tualeteve nëpër dhomat e banimit të të dënuarve, të cilat kanë nevojë për disa investime të cilat nuk varen nga ana e Institucionit tonë; dhe të cilat ne i kemi kërkuar disa herë ne institucionet përkatëse”.*

### III. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, bazuar në dokumentacionin e administruar, dhe në analizë të legjislacionit ekzistues, Komisioneri vlerëson si më poshtë:

Referuar Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2015, në konkluzionet e bëra prezent pas inspektimit të realizuar pranë I EVP-së Krujë (datë 04.05.2015) dhe në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua<sup>4</sup> **marrja e masave të menjëhershme lidhur me kushtet higjieno-**

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtësën DPB.

<sup>3</sup> Informacioni I dhënë është sjellë në kuadër të ankese tjetër, të sjellë nga shtetasi I..Smoqi, i dënuar me burgim, pranë kësaj I EVP-je.

<sup>4</sup> Shih faqen 27 të këtij raporti.

sanitare të të gjitha mjediseve të regjimit, veçanërisht në lidhje me lagështirën dhe me amortizimin e të gjithë ambienteve të brendshme të institucionit, bazuar në nenet 23 dhe 26, të ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar.

Në të njëjtën frymë me konstatimet dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit, vijnë edhe konstatimet e bëra prezent në Progres Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë<sup>5</sup>, lidhur me kushtet e IEVP Krujë.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Gjithashtu në ky Ligj, ka parashikuar në nenin 7/1: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”.* Neni 18, i saj shpreh se *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”.*

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjitha institucionet.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi.

Po sipas nenit 116 të Kushtetutës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore<sup>6</sup> është një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj dhe në hierarkinë e normave juridike renditet menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ajo zë një vend të rëndësishëm

<sup>5</sup> Progres Raporti i 2016 –ës për Shqipërinë, Bruksel, 09.11.2016, faqja 63.

<sup>6</sup> Në vijim do ti referohemi me shkurtesën KEDNJ. Ajo është ratifikuar nga RSH me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996.

në të drejtën e brendshme e bëhet e detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Neni 14, i KEDNJ, "Ndalimi i diskriminimit", përcakton se : *"Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër"*.

Nga ana tjetër, neni i 3, i saj parashikon se: *"Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, as dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues"*.

Kjo është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së<sup>7</sup>. Ligji nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Po ashtu, Shtojca e Rekomandimit 2006(2) i Këshillit të Ministrave pranë Këshillit të Evropës për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, Parimet Bazë, pika 2, citon se, *"Personat të cilëve u është mohuar liria, gëzojnë të gjitha të drejtat që nuk u janë marrë atyre në mënyrë të ligjshme nga vendimet që i dënojnë ata ose që i lënë në paraburgim"*.

Rregullorja e përgjithshme e Burgjeve, në nenin 22, pika 1, thotë se, *"Në strehimin e të burgosurve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo IEVP-je"*.

Po kështu, Ligji 9328 dt. 16.04.1998, "Për të drejtat e të dënuarve me burgim", Neni 5, paragrafi 3, shpreh se, *"Të dënuarve duhet tu sigurohen kushte jetese të tilla që ulin në minimum efektet paragjyquese negative të burgimit"*.

Komisioneri, ka konstatuar se, gjithashtu nuk janë zbatuar parashikimet ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr.8328 dt. 16.04.1998 "Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve dhe Paraburgosurve" ndryshuar me Ligjin Nr.9888 dt.10.03.2008, apo të "Rregullores së përgjithshme të Burgjeve", sikundër poshtë citohen:

- Në nenin 23 të Ligjit Nr.8328 dt. 16.04.1998 "Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve dhe Paraburgosurve" ndryshuar me Ligjin Nr.9888 dt.10.03.2008 parashikohet se: *"Ndërtesat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale me burgim duhet të projektohen, të ndërtohen apo të rikonstruktohen, në mënyrë që të plotësojnë kërkesat për një jetë normale. Ato duhet të kenë hapësira të mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta, si dhe të plotësojnë kërkesat individuale të të dënuarve apo të paraburgosurve. Rregullat dhe kriteret e hollësishme për kushtet teknike, që duhet të plotësojnë ndërtesat e reja të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale,*

<sup>7</sup> Referuar nenit 3, pika 8 ,e ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

*përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Shëndetësisë dhe të ministrit që mbulon fushën e ndërtimit.*

Sa i takon kushteve higjeno-sanitare, në nenin 33 paragrafi i fundit i Ligjit Nr.8328 dt. 16.04.1998 "Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve dhe Paraburgosurve" ndryshuar me Ligjin Nr.9888 dt.10.03.2008 parashikohet se: ***"Institutet rajonale higjeno-sanitare vizitojnë, të paktën dy herë në vit, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, për kontrollin e gjendjes higjeno-sanitare të mjediseve dhe masat e marra nga shërbimi shëndetësor i institucionit, për parandalimin e sëmundjeve infektive."***

Referuar Ligjit Nr.7643 dt.02.12.1992 ndryshuar me Ligjin Nr.9635 dt.06.11.2006 "Për Shëndetin Publik dhe Inspektoratin Sanitar Shtetëror", ***parandalimi dhe vendosja e sanksioneve për mos përmirësim të gjendjes higjeno-sanitare, qoftë dhe në institucionet e mësipërme është një detyrë funksionale e Inspektoratit Sanitar Shtetëror dhe zyrave të tij rajonale. Krahas ligjit të mësipërm, kjo detyrë buron si domosdoshmëri edhe nga legjislacioni penitenciar, në të cilin përcaktohen rregulla për një kontroll periodik dhe sistematik të parametrave higjeno-sanitar të burgjeve dhe paraburgimeve.***

Rregullorja e përgjithshme e Burgjeve, neni 94/1, pika 1, citon se, ***"Drejtori i DPB dërgon pranë I EVP-ve grupe inspektimi, të përbëra nga specialistë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve të cilat bëjnë verifikime për çështje të caktuara në urdhër". Në përmbushje të kësaj, duken marrë masa që të bëhen inspektime të herë pas hershme nga ana e DPB-së, me qëllim rregullimin e situatave të përmendura më lart.***

**Në përfundim të sa sipër cituar, Komisioneri vëren se situata aktuale (sa i takon kushteve higjeno-sanitare) i ka vënë shtetasit që vuajnë dënimin me heqje lirie në I EVP Krujë në kushte të pafavorshme dhe diskriminuuese në raport me të drejtat që u siguron gjithë legjislacioni vendas dhe ai ndërkombëtar, në kushtet në të cilat ata ndodhen. (si të dënuar me burgim).**

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Në bazë të nenit 32, pika 1, gërma "a", dhe nenit 33, pika 10, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.201 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit të të dënuarve, të cilët vuajnë dënimin pranë I EVP-së Krujë për shkak të gjendjes shoqërore.



2. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, të marrë masa për përmirësimin e situatës të sipërpërmendur, në ambientet e IEVP-së Krujë, duke bërë të mundur gëzimin e të gjitha të drejtave të parashikuara në ligj, për të dënuarit pranë këtij Institucioni.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat konkrete të marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

